


Statistikat Tregtare te Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Kinë

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), shkëmbimi tregtar me Kinë¹, në vitin 2025 deficitit tregtar ka shënuar një rritje prej 22.1% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke arritur në -922.2 milionë euro nga -755.3 milionë euro sa ishte në 2024. Mbulueshmëria e importit nga eksporti mbetet simbolike vetëm rreth 0.03%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Kinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	0.88	0.72	0.82	0.32
Import	548.6	594.0	756.2	922.5
Bilanci tregtar	(547.7)	(593.3)	(755.3)	(922.2)
% e mbulimit	0.16%	0.12%	0.11%	0.03%
Rritje Exp. (v-m-v) %	-48.5%	-17.2%	13.4%	-61.6%
Rritje Imp. (v-m-v) %	22.1%	8.3%	27.3%	22.0%
Bila. Treg. (v-m-v) %	22.4%	8.3%	27.3%	22.1%

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

¹ Kina, zyrtarisht Republika Popullore e Kinës, është një vend në Azinë Lindore, me kryeqytet Bejxhinin (Pekinin). Me një sipërfaqe prej 9,596,961 km² me rreth 1,405 milionë banorë (rreth 1.4 miliard). Bruto Prodhimi Vendor (GDP) Nominal për 2025 vlerësohet rreth 19.4 trilionë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 13,968 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 2-të më e madhe në botë nominalisht sipas FMN-së.

Analizuar në periudhën e fundit marrëdhëniet tregtare të mallrave ndërmjet Kosovës dhe Kinës karakterizohen nga një deficit i lartë dhe i vazhdueshëm tregtar në favor të Kinës. Gjatë periudhës 2022–2025, eksportet drejt Kinës janë simbolike, sillen rreth 0.8 deri 0.3 milionë euro në baza vjetore, ndërsa importet kanë shënuar një rritje mesatare vjetore rreth 19.9% nga 548.6 (v.2022) deri 922.5 milionë euro (v.2025).

Si rezultat i këtij trendi të pabarabartë tregtar, bilanci tregtar i mallrave ka mbetur vazhdimisht negativ për Kosovën. Treguesit e mbulueshmërisë tregojnë një pabarazi të thellë, shkalla e mbulimit të importeve me eksporte sillet rreth 0.16% sa ishte në vitin 2022 deri në 0.03% në vitin 2025.

Figura 2. Eksport/Importi me Kinë sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Kinë ishin rreth 0.32 milionë euro apo 0.03% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm.


Importi i mallrave nga Kina arritën në 922.5 milionë euro apo 13.1% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm.

Kinë një vend të rëndësishëm në raportet tregtare, në veçanti te importi e mallrave për në Kosovës, renditet e treta (pas Gjermanisë dhe Turqisë) në listën e 10 vendeve kryesore te importet.

Struktura e Eksportit/Importit me Kinë në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesor të Eksportit e përbëjnë: 83.6% Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike; 6.7% Mjetet e transportit; 3.3% Instr.optike, mjekësore, fotog.,muzikore...; 2.4% Tekstil dhe artikuj tekstili; 1.9% Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobileri, krevat, dyshek, jastëk..) etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm me Kinë.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rënia e eksporteve për 61.6% apo rreth 0.5 milionë euro më pak mallra në tregun kinez në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga levizjetë të sektorët si, rënie të Produkte minerale (nga 75.3% në 0.3%) dhe rritje të sektorit Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike (nga 15.7% në 83.6%), në strukturën e eksportit të vitit 2025. Kjo nuk reflekton rritje të këtij sektori, por më shumë pasqyron uljen e madhe të eksportit të Produkteve minerale, të cilat ranë nga 75.3% në vitin 2024 në vetëm 0.3% në vitin 2025.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupeve kapitujve kryesor si në vijim: 37.8% Makineri, pajisje mekanike dhe elektrike; 12.4% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.5% Tekstil dhe artikuj tekstili; 9.4% Artikuj të ndryshëm të prodhuara (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 7.2% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 4.1% Mjetet e transportit; 3.7% Veshmbathje (veshjet të këmbëve, kapela të kokës, çadrat, çadrat e diellit, bastunet, bastunet mbështetës, kamxhiket, artikujt për gjueti e pjesët prej tyre, puplat të

përgatitura e artikuj prej tyre, lulet artificiale....)etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Kina.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 22.0% apo rreth 166.4 milionë euro më shumë mallra te importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 9.5% në 12.4%) dhe një rritje e lehtë te Mjetet e transportit (nga 3.2% në 4.1%).

Përderisa makineritë mbeten kategoria kryesore e importuar, rritja e ndjeshme e sektorit të Metaleve bazë (nga 9.5% në 12.4%) tregon një varësi në rritje të industrisë së ndërtimit apo prodhimit në Kosovë nga lëndët e para kineze.

Diversifikimi i importeve, ku shtatë kategori të ndryshme kalojnë pragun prej 4% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Kina, dëshmon se Kina po konsolidohet si furnizuesi kryesor jo vetëm për teknologji, por edhe për mallra të konsumit të gjerë si tekstili dhe veshmbathjet.